

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt.27.04.2021, ( e martë ) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

## R E N D     D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Projekt Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës
4. Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2021
5. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-311, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me atë private të Hashim Rifat Berishës, ZK, Bakshi
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit

*Burim Gërguri*  
Burim Gërguri



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQI OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRQJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 1-62  
Br.

Data 21.04.2021  
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Obiliq – Skupština Opština Obilic – Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.19.03.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Burim Gërguri, Florije Jashari, Fatmir Bektashi, Hysni Mjeku, Qendresa Dubova, Linda Sadiku dhe Slavisa Spasic

**Të pranishmit tjerë:** drejtorët komunal, dhe përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues përmes platformës zoom, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kalu
3. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës Janar – Dhjetor 2020
4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Kastrioti" SH.A.
5. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq
6. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Mazgit
7. Kërkesat nga MPL, për rishqyrtim të vendimeve të Kuvendit komunal të dt. 29.01.2021 dhe atë:
  - a) Vendimi nr. – I - 09
  - b) Vendimi nr. – I - 10
  - c) Vendimi nr. – I - 11
  - d) Vendimi nr. – I - 12
  - e) Vendimi nr. – I - 13
  - f) Vendimi nr. – I - 14
  - g) Vendimi nr. – I - 15
  - h) Vendimi nr. – I - 16
  - i) Vendimi nr. – I - 17

### 8. Shqyrtimi i kërkesave

### 9. Të ndryshme

**Kryesuesi** – Kësaj radhe po e mbajmë mbledhjen pak më ndryshe, përmes zoom-it, për shkak të gjendjes së pandemisë. Pastaj, kryesuesi i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

### Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

### Pika e 2 e rendit të ditës

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

### Pika e 3 e rendit të ditës

**Kryesuesi** – Paraqiti raportin e punës së Kryetarit të Komunës Janar – Dhjetor 2020.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim Raportin e punës së Kryetarit të Komunës Janar – Dhjetor 2020.**

**Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesi –** Paraqet kërkesën e Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Kastrioti" SH.A.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën e Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Kastrioti" SH.A.**

**Pika e 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesi –** Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimitisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq.**

**Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesi –** Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Mazgit.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimitisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Mazgit.**

**Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesi –** Paraqet kërkesat nga MPL, për rishqyrtim dhe aprovim të vendimeve të Kuvendit komunal të dt.29.01.2021 dhe atë: a) Vendimi nr.-I-09, b) Vendimi nr.-I-10, c) Vendimi nr.-I-11, d) Vendimi nr.-I-12, e) Vendimi nr.-I-13, f) Vendimi nr.-I-14, g) Vendimi nr.-I-15, h) Vendimi nr.-I-16, i) Vendimi nr.-I-17.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimitisht ia rekomanduan Kuvendit komunal kërkesat nga MPL, për rishqyrtim dhe aprovim të vendimeve të Kuvendit komunal të dt.29.01.2021 dhe atë: a) Vendimi nr.-I-09, b) Vendimi nr.-I-10, c) Vendimi nr.-I-11, d) Vendimi nr.-I-12, e) Vendimi nr.-I-13, f) Vendimi nr.-I-14, g) Vendimi nr.-I-15, h) Vendimi nr.-I-16, i) Vendimi nr.-I-17.**

**Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesi –** Paraqet Ankesën nr. I-4575, e dt.01.03.2021, e cila i përcillet Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë përkatëse.

Po ashtu, kryesuesi paraqet edhe 2 kërkesa të banorëve të fshatit Mazgit për emërim të rrugëve, të cilat mbeten që në të ardhmen të trajtohen përmes Komisionit.

**Zarife Behluli –** Ju njoftoj se vendimin që e kemi marrë në fundvit 2020, për pagesën e personave të infektuar me Covid 19, i keni ndarë 90,000 €, për periudhën 2020-2021, ndërsa ne deri më tani i kemi shpenzue 60,000, që do të thotë se i kemi në disponim vetëm edhe 30,000 €. Meqë, pandemia po vazhdon propozoj që ti rekomandoni Kuvendit, për marrjen e vendimit sepse në bazë të rasteve, ato mjete nuk mjaftojnë.

**Kryesuesi –** Mendoj se për neve, nuk ka telashe vetëm që vendimi të jetë në fuqi 100 €, për të infektuar me Covid 19, dhe 300 €, për raste të vdekjes së anëtarit të familjes.

**Zarife Behluli -** Më mirë të ceket për personat e infektuar me Covid 19, në vlerën prej 100 €, dhe 300 €, për raste të vdekjes së anëtarit të familjes.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimitisht ia rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim marrja e vendimit për ndarjen e subvencioneve për personat e infektuar me Covid 19, në vlerën prej 100 €, dhe 300 €, për raste të vdekjes së anëtarit të familjes.**


**Mbledhja përfundoi në ora 10:50'**

**Bashk. prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli



**Kryesuesi i KPF**

  
Burim Gërguri